



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1512/1 Prot.

Tiranë, më 6/12/2017

Lënda: Mendim lidhur me zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT

**Për dijeni: KOMISIONIT PËR EKONOMINË DHE FINANCAT TË
KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

Tiranë

Zyra e Komisionerit ka marrë në shqyrtim shkresën tuaj nr. 1202, datë 15.11.2017, ku kërkohet mendim lidhur me zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar lidhur me publikimin e Raporteve Përfundimtare të Auditimit dhe Vendimeve të kryetarit të KLSH-së në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Ndajmë të njëjtin opinion me tuajin sa i përket detyrimeve që burojnë për autoritetet publike (në rastin konkret për KLSH-në) nga neni 7 i Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" lidhur me publikimin e të dhënave personale të zyrtarëve publikë, të dhënave që kanë të bëjnë me prokurimin publik, kontratat e lidhura me palë të treta si dhe monitorimin e zbatimit të tyre etj. Gjithashtu, e gjejmë të drejtë argumentimin tuaj ligjor ku citoni nenin 18, pika 2 e ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, në raport me përjashtimin nga kufizimet e nenit 17 të ligjit të sipërpërmendur dhe mbështesim arsyetimin se publikimi i këtyre dokumenteve apo akteve administrative është i lejuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga ky i fundit.

Sa i përket bërjes publike të kallëzimeve apo indicieve penale dërguar nga ana e KLSH-së në organin e Prokurorisë theksojmë se në bazë të nenit 281 të Kodit Procedurës Penale, kallëzimi pranë organit të prokurorisë parashikohet si një detyrim për çdo nëpunës publik i cili në kuadër të ushtrimit të detyrës merr dijeni për një fakt që përbën vepër penale. Sa më sipër njëdh logjikshëm që kallëzimi është një akt i hartuar dhe lëshuar nga

autoriteti publik (në rastin konkret KLSH-ja) i cili vë në lëvizje organin e prokurorisë. Për këtë arsye kallëzimi nuk mund të konsiderohet pjesë e procesit hetimor, dhe si i tillë t'i nënshtrohet dispozitave të Kodit të Procedurës Penale lidhur me ruajtjen e sekretit hetimor, proces ky që nis vetëm pas marrjes së kallëzimit nga organi i prokurorisë dhe vlerësimit të bërë nga ky i fundit lidhur me vijimin ose jo të procedimit penal.

Gjithashtu, pa cënuar opinionin tonë lidhur me bërjen publike të raporteve përfundimtare të hartuara nga institucioni juaj, jemi të mendimit se duhet treguar kujdes në publikimin e të dhënave të personave të tretë të cilët përmenden në mënyrë sporadike në raportet tuaja, por që nuk kanë rol përfaqësues tek operatorët ekonomike të përfshirë në procedurat e prokurimit publik objekt raportimi. Në këto raste identiteti i tyre por edhe të dhëna të tjera të cilat mund ti identifikojnë ato në mënyrë indirekte duhet bërë në formë të anonimizuar.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

